



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:005676

Datë: 23.02.2021

Numri i dokumentit: 01532996

P.nr.4/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTTRRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, me pjesëmarrjen e procesmbajtës Bahrije Smakolli, në çështjen penale kundër të pandehurit J. M. nga Vushtrria me banim në rrugën “S.”, për shkak të veprës penale, Vjedhje nga neni 313 par 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë- Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.31/21 të datës 13.01.2021 (2021:0001502), pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 22.02.2021, në praninë e Prokurorit të shtetit Sahit Tmava, të pandehurit J. M., pas shpalljes së aktgjykimit me datë 22.02.2021, me datë **23.02.2021** përpiloj, këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: J. M., nga i ati N., i lindur më dt.... në Mitrovicë, tani me banim në rr: “S.” në Vushtrri, me numër personal ..., i martuar, prind i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, edhe më parë i gjykuar me aktgjykimit P.nr.27/2002, dhe aktgjykimit P.nr.32/2006.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Me datën 12.07.2020, rreth orës 09:00, në Vushtrri, në rrugën “B. P.”, i dëmtuari N.I. para lokalit të tij kishte lënë biçikletën të pa mbyllur me çelës, i pandehuri J. me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së luajtshme për veti apo për personin tjetër, e merr biçikletën ngjyrë e bronzte me të zezë, pronë e të dëmtuarit, me ç ‘rast të njëjtit i shkakton dëm në vlerë prej 90 euro.

- **Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje nga neni 313 par.1 të KPRK-së.**

-

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 4, 7, 8, 17, 21, 38, 40, 42, 43, 44, 69, 70 dhe nenit 313 të KPRK-së si dhe nenit 365, 450, 463 të KPPK-së, e

G J Y K O N

Me DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej (6) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe me **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej 300 euro, i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Ky dënim me burgim me pëlqimin e te pandehurit me rastin e shpalljes së këtij aktgjykimit i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumën prej njëmijë euro (1000 euro).

Në bazë të nenit 76, paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 të KPRK-së, e

G J Y K O N

Me **DËNIM UNIK ME GJOBË** në shumë prej njëmijetreqind euro (300 €), i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se i akuzuari refuzon të paguaj këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të akuzuarit për çdo 20 € (njëzet euro) të dënimit me gjobë, nga 1 (një) ditë burgim.

Pala e dëmtuar N. I. sa i përket kërkesës pasurore juridike, lidhur me këtë çështje penale udhëzohet në kontest të rregullt civil.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguaj shumën prej tridhjetë euro (30€).

DETYROHET i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej tridhjetë euro (30€).

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP-II.nr-31/2021 të datës 13.01.2021 (2021:0001502), kundër të pandehurit J. M. nga Vushtrria me banim në rrugën “S.”, për shkak të veprës penale, Vjedhje nga neni 313 par 1 të KPRK-se, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 22.02.2021, në këtë seancë të shqyrtimit fillestar i pandehuri J. M. lidhur me fajësinë ka deklaruar se, e pranon fajësinë ne te gjitha pikat e aktakuzës, dhe së është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre dhe i premtojë gjykatës që në të ardhmen që kjo vepër nuk do të përsëritet.

Pretendimet e palëve gjatë shqyrtimit fillestar

Prokurori i shtetit gjatë seancës së shqyrtimit fillestar ka deklaruar se jam i pajtimit me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, meqenëse janë plotësuar kushtet ligjore për pranimin e fajësisë të përcaktuar me nenin 248 par .1 dhe i propozoj gjykatës që të bëjë pranimin e fajësisë dhe që pranimin e fajësisë ta merre si rrethanë lehtësuese, i njëjti është penduar thellë për veprën dhe se i ka premtuar gjykatës se nuk do të përsëris veprën.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka gjetur se, pranimi i fajësisë ishte në pajtim me nenin 248 të KPPK-së pasi që, i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, që do të bënin të pamundur që gjykata të bëjë vlerësimin e pranimin të fajësisë nga i pandehuri.

Provat e administruara dhe të vlerësuara në shqyrtimin fillestar

Gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësisë është i mbështetur edhe në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën dhe atë: Raport i Policit i dt. 12.07.20, në të cilin raport përshkruhet ngjarja

se si ka ndodhur rasti, Raport policor i dt. 12.07.2020 me nr. 2020-BD-0493, në të cilin raport përshkruhet rasti se si është vjedhur biçikleta e të dëmtuarit Nazif Istrefi, Procesverbal mbi marrjen në pyetje të ankuesit N. I. me nr. 2020-BD-0493, i cili në deklaratën e dhënë në polici ka deklaruar rreth vjedhjes së biçikletës së tij, dhe i njëjti ka deklaruar se djali i të pandehurit J. M.D.M. kishte shkuar tek lokali i tij dhe i kishte paguar biçikletën, ku i'a kishte dhënë 100 euro dhe i kishte kërkuar falje për rastin që ka ndodhur, Procesverbal mbi marrjen në pyetje të dyshuarit J. M. me nr. 2020-BD-0493 i dt. 25.07.2020, i cili në deklaratën e dhënë në polici ka deklaruar se, tek rruga "B. P." e kishte parë një biçikletë, e kishte vozitur gjithë ditën dhe më pas e kishte shitur për arsye se kishte mbetur pa para, dhe pasi e kishte kuptuar se e kujt ishte biçikleta, djali i tij kishte shkuar tek i dëmtuari dhe i'a kishte paguar dëmin e shkaktuar. Andaj mbi këtë bazë gjykata ka vlerësuar këto prova dhe deklarinimin mbi pranimin e fajësisë i ka vlerësuar dhe pranuar.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh se kjo vepër penale është e sanksionuar me dënim me gjobë dhe me burgim deri në (3) vite, gjykata duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, ku si rrethanë rënduese kjo gjykatë ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale, dëmin e shkaktuar ndaj palës së dëmtuar, si dhe faktin se i njëjti edhe më parë ka qenë i i gjykuar, dhe atë përmes aktgjykimit P.nr.27/2002, dhe aktgjykimit P.nr.32/2006, të gjitha këto rrethana konsistojnë në inkrimimin e të pandehurit në kryerjen e kësaj veprë penale. Si rrethanë lehtësuese gjykata ka gjetur se i pandehuri ka pranuar fajësinë, është penduar për kryerjen e kësaj veprë penale, dhe i ka premtuar gjykatës që nuk do të përsërisë vepra penale të kësaj natyre apo natyrës tjetër.

Gjykata duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se, edhe me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurve do të arrihet qëllimi i dënimit, që të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen, që të pandehurit në të ardhmen të kenë kujdes të shtuar, që të mos bien në kundërshtim me ligjin, dhe t'i parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Gjykata zëvendësimin e dënimit me burg me dënim me gjobë e ka bërë në pajtim me nenin 44 par 1 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit.

Vendimin për shqiptimin e dënimit unik me gjobë gjykata e ka marrë në bazë të nenit 76, paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 të KPRK-së, pasi që është bërë zëvendësimi i dënimit me burg me dënim me gjobë si dhe pasi që gjykata krahas shqiptimit të dënimit me burg ka shqiptuar edhe dënimin me gjobë si dënim komulativ i paraparë në këtë vepër penale, dhe në rastin konkret ka bërë unifikimin e dënimit duke zbatuar nenin e lartshënuar në mënyrë analoge.

Arsyet lidhur me vendimin për kompensimin të viktimave të krimit dhe paushallit gjyqësor

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par 2 nën par 2.6 të KPP-së.

Arsyet lidhur me kërkesën pasurore juridike

Vendimin mbi udhëzimin e palës së dëmtuar N. I. lidhur me kërkesën pasurore juridike, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 463 të KPPK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.4/2021, datë: 23.02.2021

Procesmbajtësja
Bahrije Smakolli

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej pesëmbëdhjete (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.